

ÇDO FËMIJË NË SHKOLLË!

Newsletter, Prill 2016

Përmbledhje Periodike

Në kuadër të programit “OOSC – Out of School Children”



Nisma “Çdo fëmijë në shkollë” në partneritet me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe UNICEF, zbatohet nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve.

Kjo nismë ka për qëllim monitorimin e situatës aktuale të sistemit arsimor të

Shqipërisë lidhur me çështjen e fëmijëve që kanë braktisur shkollën dhe ata që rrezikojnë ta braktisin. Kjo nismë synon nxitjen dhe mbikëqyrjen e procesit të komunikimit dhe raportimit mbi fëmijët në rrezik braktisjeje të shkollës dhe përthithjen e fëmijëve jashtë shkolle.

Nisma “Çdo fëmijë në shkollë” në partneritet me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe UNICEF, zbatohet nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve.

Kjo nismë ka për qëllim monitorimin e situatës aktuale të sistemit arsimor të Shqipërisë lidhur me çështjen e fëmijëve që kanë braktisur shkollën dhe ata që rrezikojnë ta braktisin.

Nisma “Çdo fëmijë në shkollë”

Në kuadër të zbatimit të nismës “Çdo fëmijë në shkollë”, po monitorohet procesi i zbatimit të Urdhërit të përbashkët të Rregullores 3 Ministrore “Për identifikimin dhe rregjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor” në Bashkinë Durrës.

Në konsultim me grupin e punës janë përzgjedhur **10**

shkolla pilot në Bashkinë Durrës, për monitorimin e zbatimit të Rr3M, të cilat janë: Bajram Curri 2, Bedrije Bebeziqi, Demokracia, Eftali Koci, Hasan Koci, Isuf Ferra, Kulle, Kushtrimi i Lirisë, Shkolla e Re, St. Zoot Xhafzotaj.

Disa prej arritjeve të nismës

- **Publikimi** i Udhëzuesit për monitorimin e fëmijëve jashtë sistemit arsimor në Website të 3 Ministrive:
MAS: http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/statistika/Udhezues_M4M_dhe_U3M_Redaktuar_12Shkurt2016.pdf
MSH: <http://www.shendetesia.gov.al/al/baza-ligjore/rregullore-dokumente-udhezues>
MPB: <http://www.punetebrendshme.gov.al/al/legjislacioni/udhezues/udhezues-per-monitorimin-e-femijeve-jashte-sistemit-arsimor-fjsa&page=1>
- Konfirmimi nga MAS për **gjenerimin e treguesve ndërkombëtarë** të arsimit në sistemin EMIS, si:
 - Treguesit e regjistrimit dhe të fëmijëve jashtë sistemit arsimor
 - Treguesit e rrezikut të braktisjes së shkollës, mungesave pa arsye dhe aftësisë së kufizuar
- **Kryqëzimi i listave** të fëmijëve që duhet të ndjekin klasën e parë dhe fëmijëve që janë të regjistruar në shkollë për vitin shkollor 2015- 2016, nga burime të ndryshme si: Shkollat nën varësinë e *DAR Durrës*, *MPB*, *MSH*, *FSDKSH*. Nga kryqëzimi i listave janë **evidentuar 866 fëmijë** që nuk përputhen në listat e fëmijëve të regjistruar në shkollë, të cilët po verifikohen në terren nga Bashkitë/ njësitë administrative dhe Komisariati i policisë.
- Intensifikimi i zhvillimit të **punës në terren** për verifikimin e listës së fëmijëve jashtë shkolle sipas Urdhërit të përbashkët 3 Ministror (U3M)
 - Dërgimi i listës prej 866 fëmijë, që ende nuk janë regjistruar në klasë të parë nga *DAR Durrës* në drejtim të kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore dhe shefit të Komisarariatit përkatës të policisë
 - Verifikimi në terren i listës së fëmijëve jashtë shkolle nga Njësia e qeverisjes vendore
 - Verifikimi në terren i listës së fëmijëve jashtë shkolle nga Komisariati i policisë
- **Takime periodike** ndër- institucionale dhe brenda institucionit të shkollës për fëmijët jashtë shkolle dhe në rrezik braktisjeje në Durrës. Janë zhvilluar:
 - **90 intervista**
 - **4 fokus grupe**
 - **6 sesione trajnimi** ndër-institucionale, në të cilat janë bërë pjesë rreth **165 pjesëmarrës**
 - **Workshop** me përfaqësues të *DAR/ ZA* në të gjithë Shqipërinë, më të cilët u ndanë rolet, përgjegjësitë dhe detyrat e evidentuara në U3M
 - **8 tryeza të rrumbullakëta** me aktorë të shkollës, në të cilat janë bërë pjesë rreth 200 përfaqësues të shkollave.
- **Workshop** nën autoritetin e Institucionit të Prefektit Durrës për koordinimin e identifikimit të fëmijëve jashtë shkolle.
- **Takime koordinuese** për ecurinë e zbatimit të Urdhërit të Përbashkët 3 Ministror nën autoritetin e Institucionit të Prefektit Durrës.
- **Workshop me përfaqësuesit e DAR/ ZA** në lidhje me zbatimin e U3M.
- Hartimi i manualit të një **trajnimi të plotë shkollor** mbi edukimin cilësor, njohuritë e të cilit do të transmetohen te punonjësit e shkollave.
- Hartimi i **udhëzuesit të mentorimit** të praktikave më të mira për t'u shkëmbyer ndërmjet shkollave të ndryshme.

Lista e Shkurtimeve

UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
FSDKSH	Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
DAR	Drejtoria Arsimore Rajonale
ZA	Zyra Arsimore
EMIS	Sistemi për Menaxhimin e Informacionit Arsimor
U3M	Urdhër 3 Ministror